



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 29.05.2023

Nr: 160

Ora: 13:20

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 77, DATË 22.05.2023 TË PARAQITUR NGA
“ALEANCA PROGRESISTE LZHK”**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 29.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES : Subjekti zgjedhor “Aleanca Progresiste LZHK”, përfaqësuar nga kryetari z. Fabian Topollari.

OBJEKT: 1. Ndryshim i vendimit nr. 74, datë 17.05.2023 i KZAZ nr. 15 Kurbin për shpalljen e pavlefshme të kutisë së QV nr. 0907.

Data: 29.05.2023 Nr: 160
Ora: 13:20



“Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 77,
datë 22.05.2023 paraqitur nga “Aleanca
Progresiste LZHK”

2. Numërimin e votave që gjenden në kutinë e QV nr. 0907, që i përket fshatit Shpërdhet, njësia administrative Mamurras, bashkia Kurbin.

BAZË LIGJORE:

Nenet 123/1 dhe pika 2 e nenit 124 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Rrethanat e çështjes:

1. Në datën 14.05.2023, në 61 bashki në Republikën e Shqipërisë u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Gjatë procesit të numërimit të votave, KZAZ nr. 15, bashkia Kurbin, ka miratuar vendimin nr. 15, datë 17.05.2023, me anën e të cilit ka shpallur si të pavlefshme kutinë e votimit të QV nr. 0907 që i përket fshatit Shpërdhet, njësia administrative Mamurras, bashkia Kurbin, me shkakun se kjo kuti ka patur dëmtime.
2. Kundër këtij vendimi ka paraqitur kërkesë ankimore subjekti zgjedhore “Aleanca Progresiste LZHK”, përfaqësuar nga z. Fabian Topollari i cili ka kërkuar kundërshtimin e vendimit nr. 74, datë 17.05.2023 të KZAZ nr. 15, bashkia Kurbin, si dhe numërimin e votave që gjenden në kutinë e QV nr. 0907, që i përket fshatit Shpërdhet, njësia administrative Mamurras, bashkia Kurbin, si të pabazuar në prova.
3. Ankuesi e quan të paligjshëm faktin e mospërfshirjes së rezultatit të QV nr. 0907 në tabelën e rezultateve për shkak të shpalljes së parregullt të kutisë nga ana e KZAZ, në kundërshtim me procedurat e Kodit Zgjedhor. Ankuesi pretendon se kutia e votimit ka vetëm një krisje dhe nuk është e dëmtuar në atë masë sa të cenojë integritetin e saj.
4. Kërkesa ankimore nr. 77 paraqitur në KQZ më datë 22.05.2023 iu paraqit KAS-it, i cili në seancë paraprake vendosi pranimin e saj për shqyrtim, datë 29.05.2023, me relator z. Koli Bele. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit në datën 29.05.2023, ora 13:20. Në seancë ishin të pranishëm administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaj.

Përfaqësuesi i subjektit ankues, i njoftuar rregullisht, nuk u paraqit në seancën publike të shqyrtimit administrativ.

5. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- Kërkesën ankimore nr. 77, datë 22.05.2023;
- Vendimin nr. 74, datë 16.05.2023 të KZAZ nr. 15, bashkia Kurbin për shpalljen e parregullt të kutisë së votimit të QV nr. 0907;
- Librin e Protokollit;
- Procesverbalin e Konstatimit;
- Kutinë e votimit të QV nr. 0907.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstaton:

1. Me mbylljen e procesit të votimit, referuar neneve 112 dhe vijues të Kodit Zgjedhor, KZAZ-të marrin në dorëzim kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë me materialet e votimit, nëpërmjet grupeve të marrjes në dorëzim. Në rast se gjatë marrjes në dorëzim të kutive të votimit me fletët e votimit dhe të kutisë me materialet e votimit, grupi i marrjes në dorëzim konstaton se *kutia e votimit ka në trupin ose në kapakun e saj thyerje ose çarje që lejojnë futjen apo nxjerrjen e fletëve të votimit ose materialit tjetër të votimit*, informon menjëherë KZAZ-në përkatëse, dhe pas verifikimit të KZAZ-së, në rast se konstatohet parregullsi për një të një nga kutitë me fletët e votimit, *atëherë ajo kuti vlerësohet si “KUTI E PARREGULLT” dhe dërgohet në këndin e kutive të parregullta.*
2. Pika 5 e nenit 115 të Kodit Zgjedhor përcakton se: *“Kutitë e votimit të përcaktuara si “KUTI E PARREGULLT” në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk hapen nga KZAZ-ja dhe as nuk i kalojnë Grupit të Numërimit. Ato dërgohen së bashku me kutinë e materialeve të votimit në KQZ për nevoja të hetimit administrativ ...”.*

3. KZAZ-ja nr. 15, bashkia Kurbin ka mbajtur në Procesverbalin e Konstatimit shënimin për të dhënat e kutisë së votimit të deklaruar të parregullt, duke specifikuar dëmtimin e saj.
4. Në seancën e datës 29.05.2023, KAS administroi si provë rutinë e votimit të QV nr. 0907 për të bërë këqyrjen e saj. Nga këqyrja rezultoi qartësisht se kjo kuti votimi ishte e dëmtuar në një hapësirë të madhe të saj. KAS konstaton se kutia ishte e çarë në pjesën fundore të anës së majtë në një masë të konsiderueshme.
5. KAS vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e bërë nga pala ankimuese për numërimin e fletëve të votimit që gjenden në rutinë e QV nr. 0907, pasi siç rezultoi nga këqyrja e bërë në seancën publike të shqyrtimit administrativ, kjo kuti është e dëmtuar në atë masë sa të konsiderohet e parregullt, dhe për këtë arsye, votat e gjendura në të, nuk i nënshtrohen numërimit.
6. KAS konstaton se KZAZ-ja nr. 15, Kurbin ka vepruar drejt në marrjen e vendimit nr. 74, datë 16.05.2023 për shpalljen si të parregullt të kutisë së votimit që i përket QV nr. 0907.
7. Në këto kushte, KAS vlerëson se duhet të rrëzojë ankimin e subjektit zgjedhor “Aleanca Progresiste LZHK”.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “c” dhe 143, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 77, datë 22.05.2023, të depozituar nga subjekti zgjedhor “Aleanca Progresiste LZHK”.
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 74, datë 16.05.2023 të KZAZ-së nr. 15, Kurbin.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të Kodit Zgjedhor.

U shpall sot më 29.05.2023.

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar